



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-BC-2020-06

**Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe
Jakup Krasniqit**

Vendosi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Gjykatës Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 8 shkurt 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesat e Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit në lidhje me
Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe të Kërkesës për Ndryshim sipas
Rregullës 90(1)(b)**

Prokurorit të Specializuar

Xhek Smith

Mbrojtësit të Viktimave

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Hashim Thaçit

Gregori Kihou

Mbrojtjes së Kadri Veselit

Ben Emerson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit

Dejvid Jang

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit

Venkatesvari Alagenda

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE¹, në bazë të nenit 45(2) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullës 77 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave para Dhomave të Specializuara (“Rregullorja”), lëshon këtë vendim.

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 30 tetor 2020, në vijim të vendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake për konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit (“z. Thaçi”), Kadri Veselit (“z. Veseli”), Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit (bashkërisht “të akuzuarit”),² Zyra e Prokurorit të Specializuar (“ZPS”) paraqiti aktakuzën e konfirmuar (“Aktakuza” ose “Aktakuza e Konfirmuar”), me redaktimet e autorizuara nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake.³
2. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake (“GJPP”) lëshoi Vendimin mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës.⁴
3. Më 3 shtator 2021, ZPS-ja dorëzoi Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b) (“Kërkesa e 3 Shtatorit 2021”), me të

¹ KSC-BC-2020-06, F00001, Kryetarja, *Vendim për Caktimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake*, 23 prill 2020, publik.

² KSC-BC-2020-06, F00026/CONF/RED, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Version i Redaktuar Konfidencial i Vendimit mbi Konfirmimin e Aktakuzës kundër Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit*, 26 tetor 2020, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u dorëzua më 30 nëntor 2020, F00026/RED.

³ KSC-BC-2020-06, F00034, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Konfirmuar dhe Kërkesave Lidhur me Të*, 30 tetor 2020, konfidencial, me Shtojcën 1, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, dhe Shtojcat 2-3, konfidenciale. Më 4 nëntor 2020 u dorëzua aktakuza e konfirmuar e korrigjuar më tej, në të cilën u korrigjuan disa gabime shtypi (F00045/A01), rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*, me versionin konfidencial të redaktuar (F00045/A02) dhe versionin publik të redaktuar (F00045/A03). Versioni konfidencial me më pak redaktime u dorëzua më 11 dhjetor 2020 (F00134). Pas Vendimit mbi Mangësitë në Formën e Aktakuzës, më 3 shtator 2021 u parashtrua aktakuza e konfirmuar e korrigjuar më tej, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte* (F00455/A01), me versionin konfidencial të redaktuar (F00455/CONF/RED) dhe versionin publik të redaktuar (F00455/RED). Versioni konfidencial me edhe më pak redaktime i Aktakuzës së Konfirmuar u dorëzua më 17 janar 2022, F00647/A01.

⁴ KSC-BC-2020-06, F00413, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Mocionet e Mbrojtjes për Mangësi në Formën e Aktakuzës (“Vendimi i Kundërshtuar”)*, 22 korrik 2021, konfidencial. Versioni i redaktuar publik u lëshua më të njëjtën ditë, F00413/RED.

cilën i kërkoi leje Gjykatësit të Procedurës Paraprake që të ndryshonte Aktakuzën dhe të përfshinte tri kategori (“kategoria e parë”, “kategoria e dytë”, dhe “kategoria e tretë”) të akuzave (“ndryshimet e propozuara”).⁵

4. Më 23 dhjetor 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi, ndër të tjera, lejen për ndryshimin e Aktakuzës në lidhje me kategorinë e tretë të ndryshimeve të propozuara dhe, pasi konstatoi se kategoria e parë dhe kategoria e dytë e ndryshimeve të propozuara përbënin paraqitje akuzash të reja, urdhëroi ekipet e Mbrojtjes që, në qoftë se dëshironin, të dorëzonin parashtrime mbi materialin mbështetës për këto kategori deri më 31 janar 2022 (“Vendimi i Kundërshtuar”).⁶

5. Më 17 janar 2022, Mbrojtja e z. Thaçi (“Mbrojtja e Thaçit”) dhe Mbrojtja e z. Veseli (“Mbrojtja e Veselit”) kërkuan leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar (përkatësisht “Kërkesa e Thaçit” dhe “Kërkesa e Veselit”, bashkërisht “Kërkesat e Mbrojtjes”).⁷

6. Më 27 janar 2022, ZPS-ja iu përgjigj kërkesave të Mbrojtjes (“Përgjigjja”).⁸

7. Më 1 shkurt 2022, Mbrojtja e Thaçit iu kundërpërgjigj Përgjigjes së ZPS-së (“Kundërpërgjigjja e Thaçit”).⁹

⁵ KSC-BC-2020-06, F00455, Prokurori i Specializuar, *Parashtrim i Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 3 shtator 2021, rreptësisht konfidencial dhe *ex parte*, me Shtojcat 1-5, rreptësisht konfidenciale dhe *ex parte*. Versioni i redaktuar konfidencial dhe versioni i redaktuar publik, përkatësisht F00455/CONF/RED dhe F00455/RED, u dorëzuan më 8 shtator 2021.

⁶ KSC-BC-2020-06, F00635, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 23 dhjetor 2021, konfidencial.

⁷ KSC-BC-2020-06, F00645, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kërkesë e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apelim të Vendimit lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 17 janar 2022, konfidenciale; F00646, Mbrojtja e z. Veseli, *Kërkesë e Mbrojtjes së Veselit për Leje për Apelim të Vendimit lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 17 janar 2022, konfidenciale.

⁸ KSC-BC-2020-06, F00658, Prokurori i Specializuar, *Përgjigje Përmbledhëse e Prokurorisë ndaj Kërkesave të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 27 janar 2022, konfidenciale.

⁹ KSC-BC-2020-06, F00672, Mbrojtja e z. Thaçi, *Kundërpërgjigje e Mbrojtjes së Thaçit ndaj Përgjigjes Përmbledhëse të ZPS-së ndaj Kërkesave të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit lidhur me Parashtrimin e Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesën për Ndryshim sipas Rregullës 90(1)(b)*, 1 shkurt 2022, konfidenciale.

II. PARASHTRIMET

8. Mbrojtja e Thaçit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar në lidhje me katër pikat në vijim (bashkërisht “katër pikat e Thaçit”):

- (1) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur miratoi lejen për ndryshimin e Aktakuzës lidhur me paragrafin e ri 42 të propozuar dhe paragrafin 141 të ndryshuar të Shtojcës 2 të Parashtrimit të Aktakuzës së Korrigjuar dhe Kërkesës për Ndryshim (pjesë e kategorisë së tretë të pretendimeve) përpara se i akuzuari të ketë marrë versionin me më pak redaktime të Aktakuzës dhe të Përmbledhjes së Detajuar, pasi kishte konstatuar se Mbrojtja ishte në gjendje të paraqiste “kundërshtime të njëmendta ndaj ndryshimeve të propozuara (“pika I e Thaçit”);
- (2) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se kategoria e tretë e ndryshimeve nuk përbënte parashtrim akuzash të reja brenda kuptimit të rregullës 90(2) të Rregullores (“pika II e Thaçit”);
- (3) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se ndryshimet e propozuara nuk cenonin dhe nuk binin ndesh me të drejtat e të akuzuarit, në veçanti me të drejtën për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme (“pika III e Thaçit”); dhe
- (4) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se ZPS-ja nuk tregoi mungesë zelli në paraqitjen e ndryshimeve të propozuara dhe që rrjedhimisht ndryshimet e propozuara nuk cenonin dhe nuk binin ndesh me të drejtat e të akuzuarit (“pika IV e Thaçit”).¹⁰

9. Mbrojtja e Veselit kërkon leje për të apeluar Vendimin e Kundërshtuar për gjashtë pikat në vijim:

- (1) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor kur nuk konstatoi shkelje të së drejtës për t’u mbrojtur, të paraparë në nenin 39(8) të Ligjit dhe rregullën 90(1)(b) të Rregullores, në lidhje me pretendimet e përfshira në paragrafin 42 të Aktakuzës së Propozuar (tani të Ndryshuar) që janë redaktuar në tërësi (“pika I e Veselit”);
- (2) Nëse redaktimet e zbatuara në paragrafin 42 të Aktakuzës së Ndryshuar janë në shkelje të së drejtës së z. Veseli për t’u vënë në dijeni pa vonesë për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij, e garantuar me nenin 30(1)

¹⁰ Kërkesa e Thaçit, para. 10, 19.

të Kushtetutës, nenin 6 të KEDNJ-së, dhe nenin 21(4)(a) të Ligjit (“pika II e Veselit”);

- (3) Nëse pretendimet e reja për pjesëmarrje personale mund të përbëjnë bazë më vete për konstatim fajësie, domethënë, një akuzë të re, duke qenë se ato u ricilësuan nga Paneli i Gjykatës së Apelit në pajtim me nenin 46(6) (“pika III e Veselit”);
- (4) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gaboi kur konstatoi se pretendimet e redaktuara lidhur me pjesëmarrjen personale të të akuzuarit, të përmendura në paragrafin 42 të Aktakuzës së Ndryshuar nuk bartin rrezik shtesë për konstatim fajësie (“pika IV e Veselit”);
- (5) Nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake bëri gabim ligjor kur nuk mori parasysh masat e duhura kompensuese për redaktimet e zbatuara në paragrafin 42 të Aktakuzës së Ndryshuar (“pika V e Veselit”); dhe
- (6) Nëse vlerësimi i “zellit” të prokurorisë duhet të bëhet bazuar në veprimet e ZPS-së dhe jo në fazën e procesit; nëse ndryshimet e propozuara bien ndesh me të drejtën për t’u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme; nëse shkalla e ndryshimeve shkel të drejtën për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes; dhe nëse, marrë së bashku, ndryshimet cenojnë dhe bien ndesh me të drejtat e të akuzuarit (“pika VI e Veselit”).¹¹

10. ZPS-ja parashtron se Kërkesat e Mbrojtjes duhet të rrëzohen sepse nuk përmbushin kriteret për leje për apel sipas nenit 45 të Ligjit dhe rregullës 77 të Rregullores.¹²

11. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se ZPS-ja i keqinterpretton parashtrimet e Mbrojtjes dhe rithekson se katër pikat e Thaçit janë të apelueshme.¹³ Ndonëse trajton më në hollësi vetëm pikën I dhe pikën II të Thaçit,¹⁴ Mbrojtja kërkon nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake të miratojë lejen për apelimin e të katër pikave të Thaçit.¹⁵

¹¹ Kërkesa e Veselit, para. 1-2, 26.

¹² Përgjigjja, para. 1, 28(b).

¹³ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 4.

¹⁴ Kundërpërgjigjja, para. 5-9.

¹⁵ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 10.

III. DISPOZITAT LIGJORE PËRKATËSE

12. Sipas nenit 45 të Ligjit, apelet e ndërmjetme të paraqitura nga i akuzuari apo nga Prokurori i Specializuar në pajtim me Ligjin dhe Rregulloren, shqyrtohen nga Paneli i Gjykatës së Apelit. Për apelet e ndërmjetme, përveç atyre që janë vetvetiu të lejueshme, duhet të miratohet leje nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake ose Trupi Gjykues mbi bazën se kanë të bëjnë me aspekte që do të ndikonin ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit ose në rezultatin e gjykimit dhe për të cilat, sipas mendimit të Gjykatësit të Procedurës Paraprake ose Trupit Gjykues, një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

13. Rregulla 77(2) e Rregullores përcakton më tej se Paneli miraton lejen në qoftë se vendimi lidhet me një aspekt që do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose në rezultatin e gjykimit, ndër të tjera, në qoftë se mjetet e përshtatshme juridike praktikisht nuk do të mund të miratoheshin pas mbylljes së çështjes nën gjykim dhe për të cilën një vendim i menjëhershëm i Panelit të Gjykatës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.

IV. DISKUTIM

14. E drejta për apel lind vetëm nëse Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se është përmbushur standardi ligjor për miratimin e lejes për apel, i përcaktuar në nenin 45(2) të Ligjit dhe rregullën 77(2) të Rregullores.¹⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton interpretimet e hollësishme të këtyre dispozitave që janë bërë më herët.¹⁷

¹⁶ KSC-BC-2020-06, F00172, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes së Thaçit për Leje për Apel* ("Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit"), 11 janar 2021, publik, para. 9.

¹⁷ Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 9-17.

15. Duke mbajtur parasysh se ky mjet juridik është kufizues, zbatohen kriteret konkrete të mëposhtme:

1. nëse aspekti i ngritur përbën “një pikë të apelueshme”;
2. nëse pika në fjalë do të ndikonte ndjeshëm:
 - (1) në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit, ose
 - (2) në rezultatin e gjykimit; dhe
3. nëse sipas mendimit të Panelit, një vendim i menjëhershëm i Dhomës së Apelit mund të avancojë thelbësisht procesin gjyqësor.¹⁸

A. PIKA I E THAÇIT DHE PIKAT I, II DHE V TË VESELIT

16. Mbrojtja e Thaçit argumenton se pika I e Thaçit është e apelueshme sepse kundërshton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake që i jep ZPS-së leje të ndryshojë Aktakuzën e Konfirmuar në lidhje me kategorinë e tretë të ndryshimeve të propozuara.¹⁹ Ajo parashtron se pika I e Thaçit ndikon në të drejtën e z. Thaçi për t’u mbrojtur, si pjesë e gjykimit të drejtë, para se Gjykatësi i Procedurës Paraprake të miratojë lejen për ndryshimin e Aktakuzës, si dhe në të drejtën e tij për t’u informuar pa vonesë dhe në hollësi për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij.²⁰ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtron se një vendim mbi pikën I të Thaçit mund të avancojë thelbësisht procesin sepse do të ofronte qartësi ligjore lidhur me llojin dhe hollësitë e akuzave me të cilat përballet i akuzuari.²¹

17. Mbrojtja e Veselit parashtron se pika I e Veselit është konkrete, lehtësisht e identifikueshme dhe buron drejtpërdrejt nga Vendimi i Kundërshtuar.²² Ajo

¹⁸ Vendimi mbi Lejen për Apel të Thaçit, para. 10.

¹⁹ Kërkesa e Thaçit, para. 11.

²⁰ Kërkesa e Thaçit, para. 13.

²¹ Kërkesa e Thaçit, para. 17.

²² Kërkesa e Veselit, para. 4.

argumenton se kjo pikë ka të bëjë me interpretimin e duhur të rregullës 90(1)(b) të Rregullores; më konkretisht, Mbrojtja parashtron se ajo u nuk u lejua të demonstronte se si kategoria e tretë e ndryshimeve të propozuara është e dallueshme nga pikëpamja faktike ose ligjore dhe mund të shërbejë si arsye shtesë për konstatim fajësie sepse paragrafi 42 i ndryshimeve të propozuara është tërësisht i redaktuar.²³ Mbrojtja parashtron se pika I e Veselit pa dyshim ndikon në kryerjen e drejtë të procesit dhe në rezultatin e gjykimit, sepse e drejta për t'u mbrojtur është kusht themelor për garantimin e gjykimit të drejtë.²⁴ Rrjedhimisht, një vendim i menjëhershëm nga Gjykata e Apelit do të ofronte qartësi për interpretimin e rregullës 90(1)(b) të Rregullores dhe do të shmangte shkeljen e mundshme të të drejtave kushtetuese dhe njerëzore të të akuzuarit.²⁵

18. Për sa i përket pikës II të Veselit, Mbrojtja e Veselit argumenton se, pavarësisht nga fakti nëse incidenti për të cilin flitet në paragrafin 42 të ndryshimeve të propozuara përbën ose jo akuzë të re, pika II e Veselit lidhet me të drejtat kushtetuese të z. Veseli për t'u vënë në dijeni pa vonesë për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tij dhe për të pasur kohë dhe mjete të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes.²⁶ Pasi rikujton se, duke pasur parasysh fazën në të cilën është procesi, ende është në diskutim nëse çfarëdo redaktimi i fakteve materiale të pretenduara në Aktakuzë do të ishte thjesht në shkelje të së drejtës së të akuzuarit për t'u informuar pa vonesë për akuzat kundër tij, Mbrojtja nxjerr përfundimin që çdo shkelje e së drejtës për gjykim të drejtë do të ndikojë ndjeshëm në rezultatin e gjykimit dhe, për këtë arsye, është i nevojshëm një vendim i menjëhershëm nga Paneli i Gjykatës së Apelit.²⁷

19. Për sa i përket pikës V të Veselit, Mbrojtja e Veselit argumenton se ajo buron nga Vendimi i Kundërshtuar, duke qenë se lidhet me konstatimin e Gjykatës të

²³ Kërkesa e Veselit, para. 5.

²⁴ Kërkesa e Veselit, para. 6.

²⁵ Kërkesa e Veselit, para. 6.

²⁶ Kërkesa e Veselit, para. 7.

²⁷ Kërkesa e Veselit, para. 8-9.

Procedurës Paraprake se redaktimet ishin të domosdoshme dhe proporcionale për mbrojtjen e identiteteve të dëshmitarëve dhe konfidencialitetin e informacionit lidhur me dëshmitarët në fjalë.²⁸ Duke pasur parasysh se duhet të ketë baraspeshim midis sigurisë së dëshmitarëve dhe të drejtës së të akuzuarit për gjykim të drejtë, Mbrojtja e Veselit parashtron se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk shqyrtoi masat e duhura kompensuese.²⁹ Duke qenë se pika V e Veselit ndikon ndjeshëm në rezultatin e gjykimit, Mbrojtja e Veselit argumenton se nevojitet urgjentisht një vendim i Panelit të Gjykatës së Apelit.³⁰

20. ZPS-ja përgjigjet se pika I e Thaçit përbën thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar sepse ajo kundërshton rezultatin e përgjithshëm të këtij të fundit.³¹ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se, duke pasur parasysh se redaktimet që lidhen me ndryshimet përkatëse në versionet me më pak redaktime të Aktakuzës dhe të Përmbledhjes së Detajuar sipas rregullës 86(3)(b), që u protokolluan kohët e fundit, vazhdojnë të jenë të nevojshme, fakti që Gjykatësi i Procedurës Paraprake miratoi lejen për ndryshimin e Aktakuzës përpara dorëzimit të versionit me më pak redaktime nuk është relevant dhe pika I e Thaçit është e tejkalluar.³² Ajo parashtron më tej se pika I e Thaçit nuk do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo në rezultatin e gjykimit, duke qenë se pretendimet e pasakta dhe të pambështetura në prova për shkelje të së drejtës për t'u dëgjuar janë të gabuara dhe të pamjaftueshme për t'u bërë shkas për shqyrtim në apel.³³ Sipas mendimit të ZPS-së, Mbrojtja gjithashtu nuk ka treguar se pika I e Thaçit do të avanconte thelbësisht procesin dhe, përkundrazi, miratimi i lejes për apel tani vetëm sa do të bënte që procesi të vonohej në mënyrë të panevojshme.³⁴

²⁸ Kërkesa e Veselit, para. 16.

²⁹ Kërkesa e Veselit, para. 17.

³⁰ Kërkesa e Veselit, para. 18.

³¹ Përgjigjja, para. 9.

³² Përgjigjja, para. 10.

³³ Përgjigjja, para. 12.

³⁴ Përgjigjja, para. 13.

21. Për sa u përket pikave I dhe II të Veselit, ZPS-ja përgjigjet se formulimi i tyre është tepër i gjerë dhe se ato gjithashtu përbëjnë thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar.³⁵ ZPS-ja parashtron më tej se pikat I dhe II të Veselit nuk do të ndikojnë në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit apo rezultatin e gjykimit, sepse: (i) pretendimet e pasakta dhe të pambështetura në prova për shkelje të së drejtës për t'u dëgjuar janë të gabuara dhe të pamjaftueshme për t'u bërë shkas për shqyrtim në apel; dhe (ii) ndikimi i pretenduar i redaktimeve në të drejtën për të përgatitur mbrojtjen është tejet i hamendshëm në këtë fazë.³⁶ Së fundi, sa i takon pikës I të Veselit, ZPS-ja parashtron se ofrimi i "qartësisë në interpretimin" e një dispozite nuk është i mjaftueshëm për t'u bërë shkas për ndërhyrjen e Gjykatës së Apelit;³⁷ ndërsa sa i takon pikës II të Veselit, ZPS-ja parashtron se, duke qenë se Mbrojtja e Veselit e pranon se Gjykata e Apelit është duke shqyrtuar një arsye të ngjashme për apel, një vendim mbi pikën II të Veselit nuk do ta avanconte thelbësisht procesin.³⁸

22. Për sa i përket pikës V të Veselit, ZPS-ja parashtron se ajo nuk është e apelueshme sepse Mbrojtja e Veselit nuk identifikoi asnjë masë kompensuese që Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej ta kishte shqyrtuar, por nuk e shqyrtoi.³⁹ Për më tepër, duke qenë se Mbrojtja mbështetet në supozimet e gabuara se: (i) Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk bëri asnjë diskutim të masave kompensuese; (ii) në Vendimin e Kundërshtuar nuk u dhanë vendimet mbi të cilat u bazuan redaktimet në fjalë; dhe se (iii) të drejtat e të akuzuarit duhet të kenë përparësi ndaj sigurisë së dëshmitarëve, ZPS-ja pretendon se pika V e Veselit përbën thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar.⁴⁰

³⁵ Përgjigja, para. 9.

³⁶ Përgjigja, para. 12.

³⁷ Përgjigja, para. 14.

³⁸ Përgjigja, para. 15.

³⁹ Përgjigja, para. 11.

⁴⁰ Përgjigja, para. 11.

23. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se pika I e Thaçit, në kundërshtim me atë që pretendon ZPS-ja, ka të bëjë me konstatimin konkret se Mbrojtja është në gjendje të paraqesë kundërshtime të njëmendta ndaj ndryshimeve të propozuara.⁴¹ Gjithashtu, Mbrojtja parashtron se pika I e Thaçit nuk mund të konsiderohet e tejkaluar sepse redaktimet që janë objekt i pikës I janë ende të pranishme në Aktakuzën me më pak redaktime.⁴² Së fundi, Mbrojtja kundërshton pretendimet e ZPS-së se argumentet e Mbrojtjes janë të pasakta, të pambështetura në prova dhe të përgjithshme.⁴³

24. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se pika I e Thaçit, dhe pikat I, II dhe V të Veselit, lidhen që të gjitha me aspekte të redaktimit, në veçanti me zbatimin e redaktimeve në disa pjesë të informacionit që përfshihet në kategorinë e tretë të ndryshimeve të propozuara dhe me mënyrën se si ndikojnë këto redaktime në të drejtën e të akuzuarve për t'u dëgjuar në pajtim me, ndër të tjera, rregullën 90(1)(b) të Rregullores si dhe në të drejtën për t'u informuar pa vonesë për llojin dhe shkakun e akuzave kundër tyre.

25. Rikujtojmë se në Vendimin e Kundërshtuar, pasi vuri në dukje se e drejta e Mbrojtjes për t'u dëgjuar në bazë në nenit 39(8) të Ligjit dhe rregullës 90(1)(b) të Rregullores nuk kufizohet vetëm nëse ndryshimet e propozuara janë cenuese për të,⁴⁴ Gjykatësi i Procedurës Paraprake nënvizoi se redaktimet në fjalë rrjedhin nga masat mbrojtëse të miratuara më parë, të cilat janë të domosdoshme dhe proporcionale për mbrojtjen e identiteteve të dëshmitarëve.⁴⁵ Megjithatë, u konstatua se Mbrojtja kishte qenë përgjithësisht në gjendje të paraqiste kundërshtime të njëmendta ndaj ndryshimeve të propozuara mbi bazën e versionit të redaktuar konfidencial të Aktakuzës së Konfirmuar dhe të materialit mbështetës. Në këtë kuptim, Gjykatësi i Procedurës Paraprake rikujton se e drejta për t'u dëgjuar sipas nenit 39(8) të Ligjit dhe

⁴¹ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 5.

⁴² Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 6.

⁴³ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 7-8.

⁴⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 45

⁴⁵ Vendimi i Kundërshtuar, para. 47.

rregullës 90(1)(b) të Rregullores është gur themeli i procesit penal, por ajo është dallueshme nga niveli i informacionit që i jepet Mbrojtjes dhe bazohet në atë informacion. Ndonëse të akuzuarit kanë të drejtën të marrin të gjithë materialin dhe provat relevante në pajtim me nenin 21(6) të Ligjit përpara se të dëgohen, mund të ketë interesa konkurruese të cilat duhet të peshohen kundrejt të drejtave të të akuzuarve.⁴⁶ Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se është e qartë nga Vendimi i Kundërshtuar se ai i balancoi me kujdes të drejtat e të akuzuarve sipas neneve 21(6) dhe 39(8) të Ligjit dhe rregullës 90(1)(b) të Rregullores kundrejt nevojës për mbrojtjen e identiteteve të viktimave dhe dëshmitarëve (neni 23 i Ligjit dhe rregulla 80 e Rregullores), dhe, mbi të gjitha, konstatoi se ato redaktime nuk mund të hiqen deri kur për këtë të jepet urdhër në vendimin ose vendimet përkatëse mbi masat mbrojtëse.⁴⁷ Për këtë arsye, duke qenë se pika I e Thaçit dhe pikat I dhe II të Veselit, ndonëse nisur nga këndvështrime të ndryshme, në thelb synojnë të kundërshtojnë shkallën e redaktimeve të vlerësuara dhe të zbatuara në Vendimin e Kundërshtuar,⁴⁸ sikurse është urdhëruar dhe debatuar gjerësisht tashmë në vendimin ose vendimet përkatëse mbi masat mbrojtëse, dhe në thelb synojnë të venë në dyshim baraspeshimin e vendosur nga Gjykatësi i Procedurës Paraprake midis të drejtave konkurruese, këto pika përfaqësojnë thjesht mospajtim me rezultatin e Vendimit të Kundërshtuar.

⁴⁶ *Shih* KSC-CC-PR-2017-01/F00004, Dhoma e Specializuar e Gjykatës Kushtetuese, *Aktvendim mbi Referimin e Rregullores së Procedurës dhe të Provave Miratuar nga Plenarja më 17 mars 2017, Dhomës së Specializuar të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 19(5) të Ligjit nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar*, 26 prill 2017, publik, para. 135, në fund (“Si pasojë, Gjykata pranon se parimet e gjykimit të drejtë e të paanshëm që garanton neni 31 i Kushtetutës gjithashtu mund të kërkojnë, në rastet e duhura, që interesat e të akuzuarit të drejtpeshohen kundrejt atyre të dëshmitarëve apo viktimave të cilëve u kërkohet të japin dëshmi”), me referenca të mëtejshme nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. *Shih gjithashtu* KSC-BC-2020-06, F00099, Gjykatësi i Procedurës Paraprake, *Vendim Kornizë mbi Nxjerrjen e Provave dhe Çështje Lidhur me Të*, 23 nëntor 2020, para. 46, 82 (“Në këtë kontekst, kujtojmë se është e lejueshme mosnxjerrja për Mbrojtjen e një informacioni të caktuar përpara gjykimit”), 84.

⁴⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 47. Në të përmendet poshtëshënimi 25 në Kërkesën e 3 shtatorit 2021, i cili, megjithatë, u desh të redaktohej sepse identitetet e disa dëshmitarëve mund të deduktoheshin nga paragrafë të caktuar në vendimin/vendimet përkatëse për masa mbrojtëse.

⁴⁸ Vendimi i Kundërshtuar, para. 47 (“Gjykatësi i Procedurës Paraprake i ka shqyrtuar me kujdes redaktimet e zbatuara nga ZPS-ja ...”).

26. Sa i takon pikës V të Veselit, Gjykatësi i Procedurës Paraprake është i mendimit se Mbrojtja e Veselit e keqinterpreton Vendimin e Kundërshtuar. Në fakt, në Vendimin e Kundërshtuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake i shqyrtoi me kujdes redaktimet e zbatuara nga ZPS-ja dhe konstatoi se ato ishin të domosdoshme dhe proporcionale për të mbrojtur identitetet e dëshmitarëve dhe konfidencialitetin e informacionit lidhur me dëshmitarët në fjalë.⁴⁹ Duke konstatuar se Mbrojtja përgjithësisht ishte në gjendje të paraqiste kundërshtime të njëmendta ndaj ndryshimeve të propozuara, Gjykatësi i Procedurës Paraprake në mënyrë të nënkuptuar gjykoj se nuk mund të merreshin masa të tjera kompensuese përpos atyre që tashmë ishin shqyrtuar në vendimin ose vendimet përkatëse mbi masat mbrojtëse.

27. Bazuar në sa më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se pika I e Thaçit, dhe pikat I, II dhe V të Veselit nuk janë të apelueshme. Si pasojë, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e tjera të standardit të lejes për apel që burojnë nga neni 45(2) i Ligjit dhe rregulla 77(2) e Rregullores. Rrjedhimisht, leja për të apeluar këto pika refuzohet.

B. PIKA II E THAÇIT DHE PIKA IV E VESELIT

28. Mbrojtja e Thaçit argumenton se pika II e Thaçit buron nga Vendimi i Kundërshtuar, sepse kundërshton konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se kategoria e tretë e ndryshimeve të propozuara nuk përbën akuza të reja.⁵⁰ Mbrojtja argumenton se pika II e Thaçit do të ndikonte ndjeshëm në rezultatin e gjykimit sepse do të krijonte një bazë të mundshme, të veçantë dhe të re, për konstatim fajësie.⁵¹ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtron se një vendim lidhur me pikën II të Thaçit mund të avancojë thelbësisht procesin sepse do të ofronte qartësi ligjore lidhur me llojin dhe hollësitë e akuzave me të cilat përballet i akuzuari.⁵²

⁴⁹ Vendimi i Kundërshtuar, para. 47.

⁵⁰ Kërkesa e Thaçit, para. 11.

⁵¹ Kërkesa e Thaçit, para. 14.

⁵² Kërkesa e Thaçit, para. 17.

29. Mbrojtja e Veselit parashtron se pika IV e Veselit buron nga Vendimi i Kundërshtuar dhe ka të bëjë me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se kategoria e tretë nuk paraqet bazë të re për konstatim fajësie, të ndryshme nga pikëpamja faktike dhe/ose juridike nga çka është paraqitur tashmë në Aktakuzë.⁵³ Mbrojtja argumenton më tej se, si masë kompensuese, ajo duhet të lejohet ta parashtrojë këtë pikë për shqyrtim nga Gjykata e Apelit, sepse dyshohet që është bërë një gabim juridik për shkak të redaktimeve të shumta në lidhje me një prej incidenteve në kategorinë e tretë.⁵⁴

30. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Thaçit nuk ka vërtetuar siç duhet se pse pika II e Thaçit plotëson kriteret për të qenë e apelueshme. Ajo argumenton se, gjithsesi, pika II e Thaçit është palejueshmërisht e gjerë dhe përbën thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar, sepse Mbrojtja e Thaçit nuk identifikoi saktësisht se pse Gjykatësi i Procedurës Paraprake duhej të kishte vepruar ndryshe.⁵⁵ Sa i takon pikës IV të Veselit, ZPS-ja parashtron fillimisht se parashtrimet e Mbrojtjes së Veselit lidhur me pretendimin për të drejtën e vetvetishme për apel duhet të refuzohen menjëherë.⁵⁶ ZPS-ja parashtron se, gjithsesi, pika IV e Veselit është thjesht mospajtim me Vendimin e Kundërshtuar dhe e keqinterpretton atë.⁵⁷ Më konkretisht, ZPS-ja argumenton se Veseli bën karakterizim të gabuar të kategorisë së tretë të ndryshimeve të propozuara si “pretendime të reja [për ndërmarrje kriminale të përbashkët]” ndërkohë që Gjykatësi i Procedurës Paraprake i identifikoi ato qartësisht si dy incidente shtesë që ofrojnë saktësime të mëtejshme për një formë të pjesëmarrjes tashmë të paraqitur në Aktakuzë.⁵⁸

⁵³ Kërkesa e Veselit, para. 12.

⁵⁴ Kërkesa e Veselit, para. 13.

⁵⁵ Përgjigja, para. 18.

⁵⁶ Përgjigja, para. 20.

⁵⁷ Përgjigja, para. 20.

⁵⁸ Përgjigja, para. 20.

31. Mbrojtja e Thaçit kundërpërgjigjet se palës që kërkon leje për apel nuk i duhet të specifikojë se çfarë mendon që duhej të kishte bërë ndryshe Gjykatësi i Procedurës Paraprake, por vetëm të identifikojë se si e përmbush pika përkatëse standardin ligjor të lejes për apel.⁵⁹

32. Fillimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se të dyja pikat burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar, sepse kanë të bëjnë me konstatimin e Gjykatësit të Procedurës Paraprake se kategoria e tretë e ndryshimeve të propozuara nuk përbën bazë të re dhe të veçantë për konstatim fajësie.⁶⁰

33. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se pika II e Thaçit në fakt përfshin edhe pikën IV të Veselit sepse, ndërsa e dyta u referohet vetëm ndryshimeve në paragrafin 42 të ndryshimeve të propozuara në Aktakuzë, e para i referohet kategorisë së tretë të ndryshimeve të propozuara në përgjithësi. Për këtë arsye, këto dy pika do të shqyrtohen së bashku, ku pika II e Thaçit përfshin edhe pikën IV të Veselit. Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se këto pika nuk janë thjesht mospajtime me Vendimin e Kundërshtuar, por tema më vete që burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar.

34. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pika II e Thaçit, që përfshin pikën IV të Veselit, lidhet me fushëveprimin e akuzave kundër të akuzuarve dhe, rrjedhimisht, me të drejtën e të akuzuarve sipas nenit 21(4)(a) të Ligjit për t'u informuar me kohë dhe në hollësi për llojin dhe shkaqet e akuzave kundër tyre. Në lidhje me këtë, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se është e rëndësishme që aspekte të tilla të marrin zgjidhje në një fazë të hershme, në mënyrë që të akuzuarit të kenë kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tyre, siç përcaktohet në nenin 21(4)(c) të Ligjit. Një zgjidhje e hershme e këtyre aspekteve do të thjeshtonte

⁵⁹ Kundërpërgjigjja e Thaçit, para. 9.

⁶⁰ Vendimi i Kundërshtuar, para. 26.

procesin dhe do të avanconte të drejtën e të akuzuarve për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme, sikurse përcaktohet në nenin 21(4)(d) të Ligjit.

35. Për arsyet e shtjelluara më lart, Gjykatësi i Procedurës Paraprake gjykon se edhe pika II e Thaçit, që përfshin pikën IV të Veselit, do të përfitonte nga një vendim me fuqi detyruese të Gjykatës së Apelit sa më shpejt që të jetë e mundshme, sepse kjo do të garantonte kryerjen e procesit në përputhje me kornizën ligjore të zbatueshme dhe respektimin e të gjitha të drejtave procedurale të të akuzuarve. Rrjedhimisht, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se një zgjidhje e menjëhershme e Gjykatës së Apelit në lidhje me pikën II të Thaçit, që përfshin pikën IV të Veselit, mund të avancojë thelbësisht procesin.

36. Duke pasur parasysh sa më sipër, Gjykatësi i Procedurës Paraprake miraton lejen për apelim të pikës II të Thaçit, që përfshin pikën IV të Veselit.

C. PIKA III E VESELIT

37. Mbrojtja e Veselit argumenton se pika III e Veselit buron prej Vendimit të Kundërshtuar dhe ka të bëjë me interpretimin e duhur të Ligjit, konkretisht, nëse neni 46(6) i Ligjit i lejon Trupit Gjykues ose Panelit të Gjykatës së Apelit të ndryshojë cilësimin ligjor të fakteve dhe të bëjë konstatim fajësie mbi bazën e një forme përgjegjësie penale alternative e cila nuk ishte përfshirë më parë në Aktakuzë.⁶¹ Në veçanti, me pretendimin se shprehja “mënyrat alternative të përgjegjësisë” në nenin 46(6) të Ligjit është e paqartë, Mbrojtja parashton se Gjykatësi i Procedurës Paraprake nuk e përjashtoi shprehimisht mundësinë që Trupi Gjykues ose Paneli i Gjykatës së Apelit mund të bëjë konstatim fajësie bazuar në një formë alternative të përgjegjësisë penale të cilën ZPS-ja nuk e ka paraqitur më parë në Aktakuzë.⁶²

⁶¹ Kërkesa e Veselit, para. 10.

⁶² Kërkesa e Veselit, para. 10.

38. ZPS-ja argumenton se pika III e Veselit nuk meriton leje për apel sepse ka të bëjë me një skenar hamendësues dhe hipotetik të veprimeve të mundshme në të ardhmen dhe se Mbrojtja nuk ka demonstruar se kjo pikë është e apelueshme.⁶³

39. Gjykatësi i Procedurës Paraprake vëren se, në Vendimin e Kundërshtuar, konstatoi se kompetenca e Gjykatës së Apelit për të bërë konstatime në lidhje me format alternative të përgjegjësisë penale nuk përcakton nëse një ndryshim i propozuar përbën akuzë të re.⁶⁴ Duke qenë se Mbrojtja e Veselit dëshiron që Gjykata e Apelit të qartësojë nëse neni 46(6) i Ligjit i lejon Trupit Gjykues ose Panelit të Gjykatës së Apelit të bëjnë konstatim fajësie mbi bazën e një forme alternative të përgjegjësisë penale që nuk është përfshirë më parë në Aktakuzën e Konfirmuar, Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se pika III e Veselit nuk buron nga Vendimi i Kundërshtuar, sepse ky i fundit u kufizua vetëm në konstatimin se kategoria e tretë e ndryshimeve të propozuara nuk përbënte akuza të reja brenda kuptimit të rregullës 90(2) të Rregullores dhe nuk trajtoi aspak fushëveprimin e kompetencave të Gjykatës së Apelit. Gjithashtu, Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se, duke qenë se hamendëson lidhur me kompetencat dhe të drejtat ekskluzive të Gjykatës së Apelit, pika III e Veselit ngre një çështje ligjore hamendësuese. Si e tillë, pika III e Veselit nuk është e apelueshme. Rrjedhimisht, nuk është e nevojshme të trajtohen kriteret e tjera të standardit të lejes për apel sipas nenit 45(2) të Ligjit dhe rregullës 77(2) të Rregullores. Për këtë arsye, leja për apelimin e kësaj pike refuzohet.

D. PIKAT III DHE IV E THAÇIT DHE PIKA VI E VESELIT

40. Mbrojtja e Thaçit parashtron se pikat III dhe IV të Thaçit burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar, sepse kundërshtojnë konstatimet e Gjykatësit të Procedurës

⁶³ Përgjigja, para. 19.

⁶⁴ Vendimi i Kundërshtuar, para. 27.

Paraprakes se: (i) ndryshimet e propozuara nuk cenojnë dhe nuk bien ndesh me të drejtat e të akuzuarit, në veçanti me të drejtën për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme; dhe (ii) ZPS-ja nuk ka treguar mungesë zelli në paraqitjen e ndryshimeve të propozuara.⁶⁵ Mbrojtja e Thaçit parashtron se miratimi i ndryshimeve të propozuara do të ndikonte ndjeshëm në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të gjyimit dhe do të shkaktonte vonesë të papërligjur.⁶⁶ Së fundi, Mbrojtja e Thaçit parashtron se një vendim mbi pikat IV dhe V të Thaçit në fazën e procedurës paraprake mund të avancojë thelbësisht procesin sepse do të sigurojë që e drejta e z. Thaçi për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme nuk është shkelur deri më sot.⁶⁷

41. Mbrojtja e Veselit parashtron se pika VI e Veselit buron nga Vendimi i Kundërshtuar, i cili: (i) bëri vlerësim të gabuar të zellit të prokurorisë duke u bazuar në fazën e procesit dhe jo në sjelljen e ZPS-së;⁶⁸ (ii) nuk mori parasysh se hapat proceduralë shtesë që burojnë nga ndryshimi i Aktakuzës do të shkelin të drejtat e z. Veseli për gjykim të drejtë;⁶⁹ (iii) i gjykoi gabim ndryshimet e kategorisë së parë dhe të kategorisë së dytë si "*shtesa të kufizuara në akuza*", duke shkelur të drejtën e z. Veseli për të pasur kohë të mjaftueshme për përgatitjen e mbrojtjes së tij.⁷⁰ Ai argumenton më tej se pika VI e Veselit ndikon në kryerjen e drejtë dhe të shpejtë të procesit dhe në rezultatin e gjyimit për shkak se Vendimi i Kundërshtuar cenon një numër garancish të të drejtave për gjykim të drejtë dhe, rrjedhimisht, nevojitet menjëherë një vendim nga një Panel i Gjykatës së Apelit.⁷¹

42. ZPS-ja përgjigjet se Mbrojtja e Thaçit nuk ka demonstruar se pikat III dhe IV të Thaçit janë të apelueshme dhe thjesht shpreh mospajtim me Vendimin e

⁶⁵ Kërkesa e Thaçit, para. 11.

⁶⁶ Kërkesa e Thaçit, para. 15.

⁶⁷ Kërkesa e Thaçit, para. 17.

⁶⁸ Kërkesa e Veselit, para. 22.

⁶⁹ Kërkesa e Veselit, para. 23.

⁷⁰ Kërkesa e Veselit, para. 24.

⁷¹ Kërkesa e Veselit, para. 25.

Kundërshtuar.⁷² Sa i takon pretendimit të Mbrojtjes së Thaçit se ekziston rreziku për vonesë të papërligjur, ZPS-ja përgjigjet se ky pretendim është thjesht hamendësues. Madje, sipas mendimit të ZPS-së, është miratimi i apelit ai që do të vononte procesin, duke qenë se hapat shtesë që kërkohen për ndryshimet e kategorisë së parë dhe kategorisë së dytë mund të kryhen paralelisht me pjesën e mbetur të fazës së procedurës paraprake.⁷³ Sa i takon pikës VI të Veselit, ZPS-ja parashtron se ajo nuk është konkrete në masë të mjaftueshme dhe nuk përmbush kriterin e parë të lejes për apel të përmendur më lart.⁷⁴ Gjithashtu, ZPS-ja parashtron se pika VI e Veselit është thjesht hamendësuese dhe e parakohshme dhe nuk përmbush as kriterin e dytë dhe të tretë.⁷⁵

43. Gjykatësi i Procedurës Paraprake mendon se pikat III dhe IV të Thaçit dhe pika VI e Veselit Thaçit burojnë që të tria nga Vendimi i Kundërshtuar, sepse kundërshtojnë këto konstatime të Gjykatësit të Procedurës Paraprake: (i) se nuk ka pasur mungesë zelli nga ana e ZPS-së;⁷⁶ dhe (ii) se ndryshimet e propozuara nuk do të bënin që të akuzuarit të mos kishin kohën e mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e tyre dhe as nuk do të binin ndesh në ndonjë mënyrë tjetër me të drejtat për gjykim të drejtë të të akuzuarve, përfshirë të drejtën për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme.⁷⁷ Gjykatësi i Procedurës Paraprake është bindur se këto pika nuk janë thjesht mospajtime me Vendimin e Kundërshtuar, por tema më vete që burojnë nga Vendimi i Kundërshtuar.

44. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstaton se këto pika kanë të bëjnë drejtpërdrejt me të drejtat për gjykim të drejtë dhe të shpejtë të të akuzuarve, veçanërisht me të drejtën për t'u gjykuar brenda një kohe të arsyeshme dhe të drejtën

⁷² Përgjigja, para. 23.

⁷³ Përgjigja, para. 24.

⁷⁴ Përgjigja, para. 26.

⁷⁵ Përgjigja, para. 26.

⁷⁶ Vendimi i Kundërshtuar, para. 34.

⁷⁷ Vendimi i Kundërshtuar, para. 36-37.

Gjykatës i Procedurës Paraprake

E martë, 8 shkurt 2022

Në Hagë, Holandë.